2. Të gjitha proceset e zhvillimit teknik-shkencor, në formën më të drejtpërdrejtë, gjajnë pasqyrimin e tyre në krijimin e terminologjisë së re dhe në proceset e ndërlikuara të shndërrimit të termave të mëparshëm. Gjatë këtij zhvillimi, teoritë universale bëhen të pjesshme, ncionet e pasakta saktësohen, rikuptimësohen ose, në përgjithësi, mënjanohen. Të gjitha këto lëvizje gjajnë pasqyrim në gjuhën e shkencës në trajtën e ndryshimeve përgjegjëse në nivel konceptor dhe gjuhësor. Kështu, duke fiksuar nivelin bashkëkohor të dijeve shkencore - teknike që lidhen ngushtë me nivelin e mendimit profesional, terminologjia bëhet pjesë e pandarë e çdo fushe të dijes. Por, terminologjia është edhe disiplinë e gjuhës ku diskutohet gjerë për saktësinë e përdorimit të fjalës si në asnje fushë tjeter, për saktësinë ose pasaktësinë e termave të veçantë ose edhe për grup termash të veçantë, vlerësim që bëhet nga pozita të ndryshme dhe për dukuri gjuhësore të ndryshme. Terminologjia është shtresa më dinamike e leksikut të një gjuhe përderisa është pjesë e analizës, sintezës dhe përpunimit të dijeve mbi thelbin e sendeve, dukurive e proceseve në natyrë, shoqëri e mendim. Zhvillimi i terminologjisë paraqet, gjithashtu, interes të veçantë përderisa, gjatë gjithë këtij procesi, pasqyrohet mënyra se si organizohen konceptet shkencore - teknike né gjuhë. Pra, në kuptimin më të gjerë të fjalës, terminologjia përkufizohet si pjesë e fondit të fjalorit të një gjuhe që përfshin leksikun special e që përdoret në sferën e veprimtarisë profesionale të njerëzve.

3. Kurse, terminologjia e një fushe të dijes përkufizohet si sistem i termave të një shkence që ka të bëjë me sistemin e koncepteve që i përgjigjen asaj fushe të dijes. Pra, sistemi terminologjik është sistem i tillë shenjor, përbajtja e lidhjet e të cilit janë brenda kufijve të një fushe të dijes.

Dihet që zhvillimi i shkencës dhe i teknikës është i domosdoshëm, përvèç të tjerash, edhe për përsosjen e sistemeve terminologjike speciale dhe të përgjithshme që i përgjigjen. Ky zhvillim çon, jo vetëm në lindjen e termave të rinj, por edhe të sistemeve të tëra terminologjike, jo vetëm në rindërtimin dhe saktësimin e koncepteve dhe të termave të veçantë, por edhe në rindërtimin rrënjosor të të gjithë aparatit të një varg disiplinash shkencore dhe sistemeve terminologjike përgjegjëse. Natyrisht, çdo sistem terminologjik vlerësohet nga ana e përbajtjes, domethënë, nga pasqyrimi në të i nivitet të zhvillimit të kësaj apo asaj shkence, por edhe nga formësimi gjuhësor i tij përderisa formësohet me mjete gjuhësore. Problemet gjuhësore kanë të bëjnë me kërkuesat gjuhësore që dalin nga vëzhgimet përgjithësuese dhe të veçanta për veçoritë gjuhësore dhe veçoritë e formësimit të sistemit terminologjik. Pra, sistemi terminologjik është sistem i tillë shenjor, përbajtja dhe lidhjet e të cilit janë brenda kufijve të një fushe të dijes.

PËRPUNIMI I TERMINOLOGJISË

Zhvillimi i veprimtarisë informuese, në të gjitha drejtimet, varet nga garantimi i cilësisë që jep terminologjia, kurse kjo e fundit, varet nga zgjidhja e problemeve aktuale të terminologjisë, në radhë të parë, të problemit të përpunimit të saj.

Për përpunimin e terminologjisë duhen pasur parasysh: **a)** kërkuesat e vendosura që duhet të plotësojë termi, **b)** fakti që terminologjia e një fushe nuk është një listë e rastësishme e emërtimeve të objekteve por, një sistem i termave që i përgjigjet sistemit të koncepteve, pra, dy sisteme të bashkëlidhur të një discipline të caktuar dhe **c)** lidhjet e përbajtjes së koncepteve me anën gjuhësore të termit si njësi e sistemit leksikor në të cilin funksionojnë ligjet e përgjithshme të gjuhës.

Këta faktorë kushtëzojnë, para së gjithash, hartimin e parimeve të njëjtë për përpunimin e terminologjisë në praktikë. Vëmendja në këtë proces drejtohet në analizën e pasaktësive të terminologjisë bashkëkohore dhe shkaqet e tyre, në studimin e mënyrave të formimit të

termave, në vendin që zënë huazimet në terminologjinë e fushës që përpunohet dhe, paralel, punohet për përzgjedhjen e termave që janë në përdorim.

Të gjitha fushat e shkencës dhe të teknikës lidhen ngushtë me njëra-tjetrën dhe nuk mund të zhvillohen ndaras, prandaj terminologja e çdo fushe të shkencës dhe të teknikës, qoftë dhe speciale, është, ndërmjet të tjerave, edhe e përgjithshme. Ajo nuk mund të kufizohet me interesat e një rrethi të ngushtë specialistësh, sepse rrethet e jo specialistëve, në këtë apo në atë shkallë, ndeshen me terminologjinë e fushave të ndryshme, ndaj terminologja përkatëse, duhet të jetë e saktë dhe e përshtatshme për përdorim në punën praktike. Duke u ndërgjegjësuar për nevojën e përpunimit praktik të terminologjisë shkencore, duhet vënë në dukje se etapa-kyç është hartimi i kritereve metodike dhe i kritereve shkencore të ndërtimit të terminologjisë. Kriteret metodike përbledhin: vjeljen e literaturës së fushës përkatëse dhe krijimin e kartotekës, sigurimin e kësaj literature edhe në gjuhë të huaja dhe fjalorë dy e shumëgjuhësh si dhe ngritjen e komisionit hartues ku marrin pjesë bashkëpunëtorë specialistë dhe gjuhëtarë, sepse vetëm me diskutim në komisione mund të realizohen kërkesa për një terminologi të saktësuar. Kriteret shkencore kanë në bazë kërkesa që lidhen me cilësitë që duhet të ketë termi : • çdo term shpreh tiparet-bazë të konceptit të një fushe, • në formimin e termave ka tipare që i dallojnë nga fjalëformimi në gjuhë dhe që i takojnë thjesht sferës terminologjike, • termi i një fushe të caktuar duhet të emërtojë një koncept dhc • çdo koncept duhet emërtuar nga një term.

Për të zgjedhur ose për të formuar termat e rinj, natyrisht, mbahen parasysh edhe aspekte tē tjera, si : saktësia e termit si emërtim i një koncepti, të qenët relativisht i shkurtër edhe si term-fjalë por, sidomos, jo me shumë përbërës si term-kompozitë ose si term-togfjalësh.

Këto kërkesa bëjnë të mundur formimin e termave të motivuar, të përshtatshëm për nevoja të terminologjisë, që kushtëzohen nga funksionet speciale të leksikut terminologjik, ndaj burimi më përfshirës në të cilin bazohet leksiku terminologjik është leksiku i gjuhës së përgjithshme me shtresimet e tij dhe me mënyrat e mjetet e mundshme fjalëformuese.

• Burim i rëndësishëm i pasurimit të këtij leksiku janë edhe huazimet, kryesisht termat me shtrirje ndërkombetare.

Si ndërtohet terminologjia e përpunuar, sistemi terminologjik i koncepteve të saj?

- Fillon me nxjerrjen nga kartoteka dhe zgjedhjen e termave për të hartuar fjalësin, në fillim si fjalës paraprak dhe, më pas, si fjalës i sistemuar. Roli i fjalësit të sistemuar është i dyfishtë:

Së pari, ai jep një skemë logjike të gjurmimit të termave që u përgjigjen koncepteve shkencore. Së dyti, fikson terminologjinë e formuar në mënyrë të vetvetishme, të kësaj fushe të shkencës, për të grupuar termat që emërojnë këto koncepte; fikson, gjithashtu, edhe rastet e regjistruara të sinonimisë dhe të shumëkuptimësisë.

Aspekti gjuhësor i normësimit të terminologjisë ka në bazë dy probleme: a) nga njëra anë: kriteret e përgjithshme gjuhësore dhe, nga ana tjeter; b) kriteret normative të vlerësimit të terminologjisë. Të parët ngërthejnë të tillë faktorë të rëndësishëm si: marrëdhëniet ndaj burimeve të formimit të terminologjisë dhe, gjithashtu, marrëdhëniet me dukuritë leksiko-gramatikore si edhe procese që përfshijnë, jo vetëm leksikun e përgjithshëm, por, edhe leksikun special. Të dytët përbledhin kriteret normative, lidhen me saktësinë e formimit gjuhësor dhe të përdorimit të termave në sferën kryesore të komunikimit në fushën e shkencës, pra, në letërsinë speciale dhe në komunikimin profesional.

Përpunimi gjuhësor i terminologjisë, nënkupton, para së gjithash, përpunimin e parimeve të njëjtë për formimin e termave në praktikë si dhe saktësinë e formimit gjuhësor të termit. Synohet qartësimi i mjeteve më karakteristike për terminologjinë e fushës përkatëse, duke qenë se, mënyra se si përdoren këto mjete, të çon në një aspekt tjeter siç është ai i karakterit sistemor të terminologjisë. Të gjitha këto, lidhen drejtpërdrejt me punën për normësimin e terminologjisë. Pra, lidhja më e afërt me përpunimin gjuhësor është problemi i normës.

C'përfaqëson problemi i normës në terminologji? Lidhet me konceptin e normës në gjuhën letrare, apo me konceptin e "pavarësisë" së normës në terminologji?

Norma është pasqyrimi objektiv i prirjeve që janë në shoqëri për përsosjen e gjuhës, si për gjuhën në përgjithësi, ashtu edhe për shtresimet e ndryshme të leksikut, një ndër të cilat është edhe terminologja, ndaj si kriter kryesor janë normat e gjuhës letrare.

Por, problemi i shumanshëm i normës duhet parë edhe nga këndshikimi i normësimit në fushën e leksikut special, duke pasur parasysh veçoritë e termave, jo vetëm si shenja të koncepteve speciale, por, edhe si leksik i gjuhës së shkencës me funksionet dhe veçoritë e saj. Jo trallë, ajo që nuk është e zakonshme në leksikun e përgjithshëm, është e përshtatshme dhe reale në terminologji. Pra, këto funksione e veçori të gjuhës së shkencës i jepin asaj një "pavarësi" funksionale në orientimin e përgjithshëm dhe bëjnë të mundur shfaqjen e prirjeve për "pavarësi" në fjalëformim, të ndryshme nga prirjet në gjuhën letrare. Kjo lejon që të lindë koncepti i variantit funksional të normës në terminologji, por, pa qenë në kundërshtim me normën e gjuhës letrare. Domosdoshmëria për variantin funksional të normës lind, kryesisht, në dy situata: **a)** kur ka mjete e variante fjalëformuese të shprehjes për të njëjtin koncept dhe **b)** kur shfaqen mjete të reja tipike të shprehjes së koncepteve, domethënë mjete të tillë që nuk përdoren në gjuhën letrare. Megjithatë, aspekti normativ i përpunimit të terminologjisë, që lidhet me saktësinë e formimit gjuhësor të termit, është i rëndësishëm, sepse pa këtë nuk ka siguri as për çdo term, as për sistemin terminologjik në përgjithësi.

Të gjitha aspektet e punës që u parashtruan për përpunimin e terminologjisë: • prirjet e kësaj pune, • cilësitë që duhet të këtë termi si bazë për hartimin e kritereve metodike e shkencore, • burimet që duhen shfrytëzuar, formojnë bazën për të kaluar në një shkallë tjetër që është kodifikimi i terminologjisë në fjalorin terminologjik (gjuhë amtare - gjuhë të huaja).

FJALORI TERMINOLOGJIK (SI TIP I VEÇANTË NË LEKSIKOGRIFI)

Rezultatet e punës për studimin, përpunimin dhe qartësimin e terminologjisë, zakonisht, formësohen me hartimin e fjalorit terminologjik si vepër e duhur për të bashkuar përvojën me njohuritë dhe me përpikmérinë shkencore; kjo bën të mundur plotësimin e nevojave urdhëruese të praktikës gjatë së cilës përvetësohet ky apo ai term nga gjuha dhe vërtetësohet jetësia e tij.

Puna për hartimin e fjalorit terminologjik fillon me ngritjen e sistemit terminologjik që ka në bazë fjalësin e sistemuar më parë i cili plotësohet me: **a) përzgjedhjen e fjalëve terminologjik** në bazë të analizës gjuhësore - semantike që, në një nivel të caktuar të zhvillimit të një fushe të caktuar të shkencës e të teknikës, pasqyron në mënyrë të plotë e të saktë përbajtjen tematike të saj dhe **b) sistemimin e termave** që janë në përdorim sipas një klasifikimi të caktuar që ka në bazë lidhjet brenda e ndërmjet kategorive terminologjike: objekt, hapësirë, proces, dukuri, cilësi, përkatësi etj., domethënë në bazë të marrëdhënieve paradigmatike. Me punën në fazën e parë (pika **a**) vlerësohen veçoritë gjuhësore të termave, kurse me punën në fazën e dytë (pika **b**) vlerësohen lidhjet logjike ndërmjet koncepteve, prania e dukurive kuptimore. Për sistemin e koncepteve është karakteristike zgjedhja e një grupi të caktuar të koncepteve, kurse për teorinë e terminologjisë teknike-shkencore ka rëndësi studimi i grupeve leksiko-semantike që u përgjigjen atyre.

Duhet pasur parasysh edhe fakti që, me hartimin e fjalorit terminologjik, nuk synohet, së pari: inventarizimi i koncepteve speciale, por bashkërendimi i mjeteve gjuhësore për shprehjen e këtyre koncepteve dhe, së dyti: jo ç'përfaqëson ky apo ai koncept por, të tregohet se ç'koncept emërtion ky apo ai term.

Kështu plotësohet fjalësi i termave në gjuhën amtare si fazë e parë e punës me fjalorin. Në fazën e dytë, ky fjalës plotësohet me barasvlerësit në gjuhët e huaja (jo me përkthimin e tyre). Nga ana strukturore ky fjalës me termat në gjuhën amtare, i plotësuar me termat barasvlerës në gjuhët e huaja, përbën pjesën e parë të fjalorit, atë që quhet baza e fjalorit. Në fazën e tretë fillon diskutimi i bazës, term për term, si në gjuhën amtare, ashtu edhe për barasvlerësit në gjuhët e huaja nga komisioni hartues i përbërë nga specialistë e gjuhëtarë. Në këtë fazë diskutimet bëhen për problemet gjuhësore që dalin në tri drejtimet e punës me terminologjinë që janë: bashkërendimi, standartizimi dhe njësimi i terminologjisë së një fushe të shkencës dhe të teknikës.

a) Me bashkërendim të terminologjisë, në rrafshin leksikor, synohet: bashkëgjegjja, në shkallën më të mundur, e termit me konceptin e emërtuar dhe në rrafshin fjalëformues: saktësimi dhe përsosja e përdorimit të mjeteve gjuhësore të formimit të termave për të ndrequr termat që nuk janë emërtime të sakta ose për shkak të formimit jo të drejtë, ose për shkak të përdorimit jo të drejtë, si dhe për formimin e termave të rinj.

b) Me standartizim të terminologjisë synohet të arrihet emërtimi i çdo koncepti nga një term dhe çdo term të emërtojë një koncept me qëllim që të mënjanohen dy dukuritë kuptimore si sinonimia dhe shumëkuptimësia, të cilat janë dukuri jopozitive për terminologjinë.

c) Me njësim të terminologjisë synohet të arrihet bashkëgjegjja e koncepteve shkencore që emërtohen me terma barasvlerës në gjuhë të ndryshme (jo me përkthimin e tyre), duke ruajtur kështu, veçoritë e çdo gjuhe në formimin e termave në mënyrë që të sigurohet komunikimi i saktë i specialistëve ndërmjet tyre dhe shmangia e moskuptimeve.

Për të siguruuar këtë barasvlerësi shfrytëzohen fjalorë terminologjikë dy e shumëgjuhësh për fushën përkatëse, tekste mësimore, standarde shtetërore, letërsi për probleme të ndryshme të fushës përkatëse në gjuhë të ndryshme etj..

Në fazën e katërt hartohen treguesit e termave gjuhë e huaj - gjuhë amtare. Treguesit ndihmojnë të dalin në pah pasaktësitë dhe mangësitë në punën gjatë diskutimit të bazës. Ata janë "redaktorët" e parë të bazës. Kryesisht, probleme shkaktojnë dukuritë kuptimore, pasi edhe në këtë rast, shfaqet një term në gjuhë të huaj si emërtim për dy terma në gjuhën amtare, ose dy terma në gjuhë të huaj për një term në gjuhën amtare.

Treguesit e termave gjuhë e huaj - gjuhë amtare përbëjnë pjesën e dytë të fjalorit në anën strukturore të tij. Përveç dy pjesëve kryesore, bazës me fjalësin në gjuhën amtare të plotësuar me barasvlerësit në gjuhët e huaja dhe treguesve (gjuhë të huaja - gjuhë amtare) mund të ketë edhe shtesa, si: listë me shprehje që përdoren në fushën përkatëse, listë me emra institucionesh, sipas rastit, kombëtare e ndërkombëtare etj. që, natyrisht, nuk hyjnë në fjalësin e fjalorit.

Në fazën e pestë bëhet redaktimi përfundimtar (i bazës e i treguesve) dhe përgatitja për botim e fjalorit.

Natyrisht, në punën me fjalorin terminologjik ndeshesh edhe me vështirësi, ndër të cilat më kryesoret lidhen, së pari, me plotësinë e fjalës. Shkak është, para së gjithash, ndryshimi i pandërrerë i plotësimit të tij me terma të rinj i shkaktuar nga zhvillimi, mund të thuash, i shpejtë i shkencës dhe i teknikës; me shfaqjen e drejtimeve të reja shkencore si dhe me cilësinë e vjeljeve të letërsisë së fushës në gjuhën amtare (ndaj kjo e fundit duhet zgjedhur nga burime autoritare).

Ndikon edhe fakti që nuk ka një mendim për problemin se cili term hyn ose nuk hyn në sistemin terminologjik, prandaj, në përgjithësi, gjerësia e përfshirjes së termave në sistemin terminologjik përcaktohet nga nevojat e praktikës, duke pasur parasysh, natyrisht, edhe perspektivën e zhvillimit të jetës ekonomike e shoqërore dhe të zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare. Së dyti janë vështirësi që lidhen me barasvlerësinë e termave në gjuhën amtare me termat në gjuhët e huaja, por edhe ndërmjet termave në gjuhë të huaja. Për të siguruar këtë barasvlerësi shfrytëzohen, kryesisht fjalorë terminologjikë dy e shumëgjuhësh përfshirë përkatëse të përzgjedhur sipas kritereve të veçanta. Së treti, krijojnë vështirësi termat sinonimë, sidomos përdallimi (diferencimi) funktional i sinonimeve. Duhet vënë në dukje se, ashtu si për mënjanimin e sinonimeve, edhe përsigurimin e barasvlerësisë, pak ndihmojnë edhe fjalorët terminologjikë dy e shumëgjuhësh të botuar, sepse edhe në këta fjalorë, të cilët zakonisht, janë të hartuar kryesisht nga specialistë të fushave përkatëse, jo në pak raste, gjen dy - tre terma për një koncept dhe duhet të zgjedhësh vetëm njërin prej tyre që të jetë jo vetëm emërtimi i vetëm i konceptit, barasvlerës i termit në gjuhën amtare, por, edhe i termave në gjuhët e tjera.

Suksesi i punës së komisionit hartues me terminologjinë, në thelb, varet : a) nga detyrat që vihen në çdo fazë të punës dhe nga niveli i kësaj pune për zbatimin e tyre. Vetëm kështu arrihet, jo vetëm realizimi i detyrave në të tri aspektet e përpunimit të terminologjisë, por, edhe ngulitja e termave në praktikën gjuhësore; por dhe b) nga vazhdimësia e punës me terminologjinë, që është jo më pak e rëndësishme, sepse vetëm kjo mund të garantojë, që terminologjia e çdo fushe, jo vetëm të ndjekë përparimin e fushës përkatëse të shkencës e teknikës, por edhe ta ndihmojë këtë përparim dhe të ngrihet në nivelin bashkëkohor të zhvillimit të kësaj fushe.

FJALORËT TERMINOLOGJIKË (SHQIP - GJUHË TË HUAJA)

1. Një nga problemet, gjithnjë aktual dhe i ndërlikuar, që lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e gjuhës letrare kombëtare është problemi i terminologjisë. Në fondin e fjalorit të gjuhës letrare zë vend të rëndësishëm leksiku terminologjik, sepse dihet që në gjuhë hyjnë vazhdimisht terma të rinj, por edhe sepse, me zgjerimin e funksioneve shoqërore të

gjuhës në çështjet e prodhimit, në arsim, në botimin e teksteve shkolllore, në përkthime, për nevoja të shtypit, lind nevoja e domosdoshme për terma.

Në këto kushte, përpunimi i terminologjisë dhe hartimi i fjalorëve terminologjikë përfshin ndryshme të dijes, ka qenë, ndërsa vite, një nga problemet gjuhësore kryesore edhe për gjuhën shqipe, ndaj edhe objektivat e caktuara ishin: përpunimi i terminologjisë teknike-shkencore në rrafshin gjuhësor dhe hartimi i fjalorëve terminologjikë (shqip - gjuhë të huaja), hartimi i kritereve shkencore e metodike mbi të cilat do të punohej për hartimin e këtyre fjalorëve dhe forma e organizmit të punës, përfshirë edhe përvojën e vendeve të tjera.

Fjalorët do të hartoheshin detyrimisht me komisione të përbërë nga specialistë të fushave të ndryshme të shkencës e teknikës dhe nga gjuhëtarë. U fillua puna, jo rastësisht, me fushat që ishin lëndë mësimore në shkollë sikurse vihen në dukje në referatin e mbajtur në Konferencën shkencore për terminologjinë². Këto kriteri dhe kjo mënyrë organizimi vijojnë të janë të vlefshme edhe në ditët e sotme, sepse patën në bazë bindjen e gjuhëtarëve tanë se gjuha jonë, ashtu si dhe gjuhët e tjera, i ka të gjitha mundësitë për të përballuar nevojat e praktikës, me mjetet e veta, në fushën e terminologjisë. Me këtë punë, të bazuar mbi këto kriteri shkencore, janë hartuar, që nga vitet '50 të shekullit të kaluar, mbi 30 fjalorë terminologjikë të fushave të ndryshme (shqip - gjuhë të huaja), me mbi 60 000 terma.

Përveç paraqitjes së yellimit të punës, parë në numrin e fjalorëve të botuar, po në këtë referat, vihen në dukje, gjithashtu, edhe disa aspekte të kësaj pune, sepse kjo punë, e shtrirë në kohë, ka pasur shkallëzimet e veta dhe kërkesat për ngritjen e cilësisë: **a)** Me fjalorët e parë u plotësua nevoja e ngutshme për një terminologi të përpunuar. Këta fjalorë hodhën një bazë të shëndoshë e hapën një hulli të sigurtë në të cilën vijoi puna më vonë.

b) Me këtë përvojë pune ekipi i terminologëve, i shtuar në numër, rriti kërkesat: • për hartimin e fjalorëve u ngritën kartoteka mbi bazën e vjeljeve të letërsisë së fushës përkatëse; • nga dy barasvlerës në gjuhë të huaja (frëngjisht dhe rusisht) u arrit në pesë

² Hëna Pasho, Agron Duro, Terminologia shqipe - probleme dhe detyra, (referat i mbajtur në Konferencën shkencore: "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe - Probleme dhe detyra"), fq. 21, Tiranë, 2009.

barasvlerës (u shtuan barasvlerësit në anglisht, italisht dhe, në ndonjë fjalor, edhe në gjermanisht).

c) Për të ndjekur më mirë problemet, u bë edhe profilizimi i gjuhëtarëve-terminologë sipas një drejtimi të përgjithshëm të fushave për shkencat shoqërore dhe shkencat teknike.

Pas paraqitjes dhe analizës së punës me terminologjinë për një periudhë, jo të shkurtër (nga vitet '50 të shekullit të kaluar deri në vitet 2000), arrihet në përfundimin se puna për normësimin e terminologjisë, e ndërtuar mbi parime shkencore në të gjitha aspektet, dha frytet e veta. I gjithë ky fond termash të përpunuuar u bë i detyrueshëm për t'u zbatuar dhe, kështu hyri në përdorim, së pari në tekstet shkollore dhe u përvetësua nga nxënës e studentë, u përvetësua nga specialistë të fushave të ndryshme dhe u përdor në letërsinë shkencore, në gjuhën e medias, u përdor jo vetëm në fjalorët e gjuhës shqipe, por, edhe në fjalorët dygjuhësh, pra, në të gjitha stilet e gjuhës. Ngulitja në përdorim e gjithë këtij fondi termash të përpunuuar ka rëndësi praktike pasi lidhet ngushtë me funksionimin e vetë gjuhës e sepse, shtimi i vazhdueshëm i sasisë dhe denduria e përdorimit të termave teknikë-shkencorë në komunikim, përveç se e kanë pasuruar gjuhën, i kanë dhënë asaj edhe saktësinë si mjet komunikimi shkencor.

FJALORI I TERMAVE TË URBANISTIKËS (SHQIP - FRËNGjisHT - ANGLISHT)

1. Terminologjia, siç dihet, fikson nivelin bashkëkohor të dijeve teknike-shkencore dhe lidhet ngushtë me mendimin profesional. Zhvillimi i shkencës dhe përparimi teknik, komunikimi shkencor, procesi mësimor, janë të pamundur pa një terminologji të përpunuuar në çdo gjuhë, ku terma me përbajtje të njëjtë, por, me emërtime në gjuhë të ndryshme, të kuptohen njësoj nga të gjithë. Nga ana tjeter, edhe përparimi i shkencës dhe i teknikës, procesi i zhvillimit të shoqërisë, përcaktojnë zhvillimin e mëtejshëm të terminologjisë dhe gjithashtu, nevojën e vazhdueshme për përsosjen e saj, duke ditur se shkenca bashkëkohore teknike karakterizohet nga përdallimi dhe specializimi.

Domosdoshmëria e përpunimit të terminologjisë kushtëzohet, së pari, nga numri jo i paktë i fushave me terminologji të formuar në mënyrë të vetëvetishme dhe, së dyti, nga niveli i lartë i zhvillimit të shkencës.

Në gjuhët bashkëkohore ndodhin tri procese të bashkëlidhura dhe të bashkëkushtëzuara:

a) përdallimi i mëtejshëm i terminologjisë sipas fushave, b) plotësimi i ndërsjellë, gjithnjë në rritje, i sistemeve terminologjike të një gjuhe, në veçanti, c) përpunimi i emërtimeve të përgjithshme për nocionet që janë specifike për terminologjitë, ç) shtimi i pandërpërre i fondit të termave të huaj, kryesisht i termave të huaj me shtrirje ndërkombëtare. Tri proceset e para baraspeshojnë njëri-tjetrin brenda se cilës gjuhë në rrafshin ndërdisiplinor, kurse në procesin e katërt ky baraspeshim gjuhësor bëhet ndërmjet termave në gjuhën armtare me termat në gjuhë të huaja.

Kështu leksiku terminologjik ngulitet intensivisht në gjuhë dhe problemet gjuhësore që shoqërojnë këtë proces janë të lidhura ngushtë me shkallën e funksionimit të gjuhës, sepse plotësimi i sistemit varet nga shkalla e përdorimit të vetë gjuhës me cilësinë e mjetit me të cilin bëhen të njohura bazat e kësaj apo asaj shkencë.

2. a) Me kalimin e kohës ndihet nevoja për normalizimin e terminologjisë dhe bëhen përpjekje për ta vënë punën mbi baza shkencore, duke hartuar fjalorin terminologjik të fushës përkatëse.

Fjalorët, në përgjithësi, luajnë rol të rëndësishëm në jetën e njerëzve, sepse bëjnë të mundur komunikimin e tyre në gjuhë të ndryshme, shërbijnë si mjet i studimit të gjuhës amtare dhe të gjuhëve të huaja, ndihmojnë jo vetëm në përvetësimin e dijeve, por edhe si mjet për të ngritur nivelin e tyre. Ndërmjet tyre, fjalorët terminologjikë, luajnë rol të veçantë në zhvillimin e shkencës e teknikës, pikërisht, për nevojat praktike. Dhe atëherë, kur duhen hartuar fjalorë për këto fusha, leksikografëve u jepet mundësia të përzgjedhin një numër të domosdoshëm termash aktualë të këtyre fushave.

b) Edhe në gjuhën shqipe, ndër fjalorët me të cilët u pasurua leksikografia, natyrisht, ishin edhe fjalorët terminologjikë, hartimi i të cilëve kushtëzohej me zhvillimin e gjuhës, me procesin e normalizimit të saj dhe me lindjen e fushave të shkencës e të teknikës. U krijuar kështu, një bazë faktike e gjerë për një terminologji të përpunuar të fushave kryesore të dijeve shkencore. Ky fond termash zuri vend e luajti rol të rëndësishëm në pasurimin e fondit të fjalorit të gjuhës shqipe, por edhe në jetën e shoqërisë.

c) Duke pasur në bazë përvojën shumëvjeçare të punës së sektorit të terminologjisë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë për përpunimin e terminologjisë në kushtet e terminologjisë dy e shumëgjuhëshe dhe kodifikimin e saj në fjalorë shqip - gjuhë të huaja, rezultat i së cilës, siç u përmend më lart, është hartimi dhe botimi i më shumë se

30 fjalorëve, u fillua puna për hartimin e fjalorit të termave të urbanistikës (shqip - frëngjisht - anglisht).

Kjo përvojë për përpunimin dhe funksionimin e terminologjisë në gjuhë, pikërisht, përvoja e përpunimit të terminologjisë në kushtet e terminologjisë dy e shumëgjuhës, lidhur me ecurinë e punës për hartimin e këtyre fjalorëve, është përvijuar në punimin që i është bashkëngjitur këtij fjalori, që fillon me • hartimin e kritereve metodike-shkencore, duke pasur parasysh • karakteristikat që duhet të ketë termi, • prirjet e kësaj pune, • burimet që duhen shfrytëzuar për zgjidhjen e problemeve, • qëndrimin ndaj dukurive jopozitive që shoqërojnë terminologjinë gjatë funksionimit të saj, • qëndrimin ndaj huazimeve.

ç) Në hulli të kësaj përvije eci edhe puna për hartimin e këtij fjalori, duke përdorur, së pari, burime që mund të grupohen të rëndësishme: botime zyrtare, tekste mësimore dhe studime për probleme të fushës, studim sistematik i periodikëve me këto studime dhe, së dyti, punime leksikografike dhe, natyrisht, fjalorë terminologjikë dy e shumëgjuhësh.

Grupi i parë, natyrisht, është baza e fjalorit, sepse përmban terminologjinë e re të cilën e shfaq në mjedis të ndryshëm gjuhësor edhe në togfjalësha të ndryshëm. Grupi i dytë plotëson kriteret metodike, sepse në bazë të tyre bëhet i mundur përdorimi i përvojës së terminografisë së vendeve të tjera.

Bazën e fjalorit e përbëjnë, kryesisht, termat që lidhen me emërtimin e fushës, domethënë, termat: urban, urbanistik, urbanistikë, urbanizim: element urban, fizionomi urbane, formë urbane, hapësirë urbane, korridor urban, mjedis urban, mobilim urban, model urban, morfollogji urbane, ndërtim urban, nyje urbane, objekt urban, pëlhurë urbane, strukturë urbane, tatëpjetë urbane, tjetërsim urban, visore urbane etj; analizë urbanistike, ansambël urbanistik, bërthamë urbanistike, detyrë urbanistike, ide urbanistike, hapje urbanistike, kompozim urbanistik, koncept urbanistik, mendim urbanistik, ndërhyrje urbanistike, plan urbanistik, problem urbanistik, rregullim urbanistik, sistem urbanistik, shndërrim urbanistik, tipologji urbanistike, zgjidhje urbanistike etj.; histori e urbanistikës; urbanizim i territorit, çurbanizim i territorit, mundësi urbanizimi, proces urbanizimi, sistem urbanizimi etj..

Si për çdo fjalor terminologjik, edhe për fjalorin e termave të urbanistikës, është pasur parasysh edhe se në ç'masë do të përfshiheshin termat e fushës së ndërtimit dhe të arkitekturës, si dy fusha të afërtë me urbanistikën.

Në zgjedhjen dhe në sasinë e termave që do të përfshiheshin në fjalorin e urbanistikës, nga këto dy fusha, në vijimësi të punës, ndihmon vetë objekti i punës së urbanistikës që, kryesisht, është organizimi i mënyrës së vendosjes së objekteve që ndërtohen në sipërfaqen ndërtimore. Parë në këtë aspekt, janë përfshirë në këtë fjalor rreth 70 termatogfjalsha që emërojnë nacione kryesore të fushës së ndërtimit: ndërtesa-t, ndërtesa-a, ndërtim-i, ndërtime-t, ndërtimor: ndërtesa në bllok, ndërtesa në vijë të drejtë, ndërtesa të dendura, ndërtesa të grupuara, ndërtesa të përngjitura, ndërtesa të veçuara etj.; ndërtesë me drejtim të detyruar; ndërtim i rrëmujshëm etj. Përveç këtij grapi termash-togfjalësha, natyrisht, ka edhe terma-togfjalësha të tjera që lidhen me këto koncepte kryesore si: kategori e ndërtimeve, ndërtime dypërmasore, ndërtime tripërmasore; sipërfaqe ndërtimore, skelet ndërtimor, strukturë ndërtimore, vëllim ndërtimor, vijueshmëri ndërtimore, zonim ndërtimor etj; që lidhen me vëllimin e ndërtimeve, me pjesë kryesore të strukturës ndërtimore, me organizimin e sipërfaqes ndërtimore etj..

Kurse nga fusha e arkitekturës janë përfshirë në fjalor kryesisht terma që kanë të bëjnë me balloren e ndërtesës, si elementi kryesor i saj, që përcakton edhe mënyrën e organizimit urbanistik: ballore e dritësuar, ballore e myllur, ballore plastike, ballore të vazduhuara; ansambël urbanistiko-arkitekturor.

Për sasinë e paktë të termave nga fusha e arkitekturës ka edhe një arsy: për fushën e arkitekturës ka një fjalor terminologjik (shqip-rusisht-frëngjisht)³, kurse për fushën e ndërtimit nuk ka një fjalor të tillë normativ.

Mbi këtë bazë të gjerë materiali faktik është bërë përzgjedhja e termave për fjalësin e sistemuar. Pjesën më të madhe të termave që përfshihen në fjalësin e sistemuar e përbëjnë, sikurse u përmend edhe më lart, konceptet dhe kategoritë urbanistike, gjithashtu, objektet e vrojtimeve dhe të analizave urbanistike që gjenden në botime, terma specifik për lexuesin shqiptar, por që gjenden edhe në letërsinë e huaj.

³ Fjalor i termave të arkitekturës (shqip-rusisht-frëngjisht), Sektori i Terminologjisë, Akademia e Shkencave e RPSh, Instituti i Gjuhësise dhe i Letërsisë, Tirana, 1964.

Kriteri kryesor i përgjedhjes së termave ka qënë, si për të gjithë fjalorët terminologjikë, bashkëkohësia, shtrirja në përdorim, shpeshtësia e përdorimit në botime të ndryshme për probleme të urbanistikës.

Natyrisht, nga letërsia e gjerë dhe vjetjet e bollshme të termave të urbanistikës u sigurua një bazë faktike e materialit që bëri të mundur përgjedhjen e termave sipas kritereve të përcaktuara edhe për hartimin e këtij fjalori terminologjik jo të vëllimshëm, por të pasur me terma aktualë të kësaj fushe.

- Puna për hartimin e këtij fjalori filloi me klasifikimin e materialit: a) në fusha dhe, sipas tyre, b) në kategori terminologjike me lindjet ndërmjet dhe brenda tyre; objekt, hapësirë, proces, dukuri, cilësi, përkatësi që ndihmojnë në procesin e sistemimit.

Fusha: urbanistikë, arkitekturë, ndërtim;

Objekte: ndërtesa (grupimet në ansambël, korpus, kompleks);

Hapësira: zonë, territor, truall, sipërfaqe, rrjet rrugor;

Procese: projektim, kompozim, strukturim, modelim, planëzim, harmonizim, ndërtim, zonim etj.;

Dukuri: tatëpjetë (*urbane*), çurbanizim, riurbanizim, përtëritje (*urbane*), shndërrim (*urbanistik*), tjetësim (*i tipologjisë urbanistike*), shformim (*i territorit*) etj.;

Cilësi: (*ansambël*) i qetë, dinamik, i dendur; (*hapësirë*) e ndërlikuar, e thjeshtë; (*kompozim*) i lirshëm; (*studim*) i hollësishëm; (*zhvillim urbanistik*) i qëndrueshëm, i paqëndrueshëm etj.;

Përkatësi: (sipas fushës), në bashkëvajtje me mbiemrin ndërtimor: hapësirë, kompleks, strukturë, vijueshmëri; njësi (*urbanistike*), koncept (*urbanistik*) dhe ansambël (*urbanistiko-arkitekturor*) etj..

Si një aspekt tjetër i karakterit sistemor të fjalësit, është pasur parasysh edhe a) një shkallëzim konceptual në këto raste: çështje - problem - mendim - ide - koncept - parim - studim - zgjidhje (*urbanistik-e*).

b) Si proces (në studio): kompozim - modelim - përvijim - planëzim - projektim - strukturim etj.; (në terren); mbulim (*i territorit me...*) - organizim (*i hapësirës*) - pajisje (*e territorit me...*)
- përdorim (*i territorit*) - shfrytëzim (*i hapësirë urbane*) - trajtim (*urbanistik*) - zonim (*urbanistik*); etj.

- Dihet që çdo sistem terminologjik vlerësohet si nga ana e përbajtjes, domethënë, nga shkalla e pasqyrimit në të të nivitet të zhvillimit të kësaj apo asaj shkencë, po ashtu, edhe

nga formësimi i tij gjuhësor përderisa terminologjia formësohet me njete dhe sipas rregullave të gjuhës letrare, natyrisht, sipas specifikës së terminologjisë në përdorimin e mjeteve e rregullave të gjuhës letrare, domethënë, **a)** në përshtatjen e mënyrave dhe modeleve-bazë të fjalëformimit të gjuhës letrare dhe modeleve specifike të formimit të termave dhe **b)** lidhur me variantet fjalëformuese, duke pasur parasysh prirjet-bazë të zhvillimit të sistemit të fjalëformimit, prirjet ndaj rregullsisë së funksionimit të modeleve të fjalëformimit ndaj specializimit, të kuptimit të ndajshtesave fjalëformuese dhe modeleve, ndaj formimit në çerdhe të fjalëve-terma dhe të procesit të bashkërendimit.

Këto rregulla janë në bazë të punës me terminologjinë. Specifika e punës me çdo fjalor përmblidhet në rrugët që përdoren, duke pasur parasysh veçoritë e gjuhës, pasurinë e saj leksikore dhe sa e si përdoren të gjitha mjetet e saj leksikore që u përgjigjen ligjeve të përgjithshme të gjuhës letrare në tri aspektet e punës me terminologjinë: bashkërendimit, standardizimit dhe njësimit.

1- Në aspektin e parë vëmendja është përqëndruar në rishikimin dhe përgjedhjen e termave të formuar me materialin e vetë gjuhës në dy rrafshe: në rrafshin leksikor dhe në rrafshin strukturor-fjalëformues.

- a) • Në rrafshin leksikor: është bërë e mundur që të jenë të paktë termat fjalë të huaja, pjesën mbizotëruese e përbëjnë fjalët shqipe; • terma shqip: bosht, hapësirë, nyje, bërtamë, gjurmë etj.;
 - fjalë të leksikut të përgjithshëm: copëtim, skaj, zgjidhje, ngushtim, prishje, zgjerim etj.;
 - fjalë dialektore, krisë, amulli, ngërç etj..

Lidhur me përgjedhjen dhe përdorimin e fjalëve të huaja të shqipëruara janë përdorur fjalë-terma të shqipëruar në fusha të tjera që, në bashkëvajtje me një term tjetër në togfjalësh, përbëjnë terma të urbanistikës si, psh: bashkërendim (*i planeve të urbanistikës*) për: koordinim, bosht (*kompozimi*) për aks, (*element*) thelbësor për: esencial, (*formë*) yjësi për: konstelacion, (*hapësirë*) e ndërlikuar për: komplekse, (*hapësirë*) tripërmasore për: tridimensionale, visore (*urbane*) për: peisazh, ballore për: fasadë etj.

Fakti që edhe në këtë terminologji pjesën mbizotëruese të fjalësit të fjalorit e përbjnjë fjalët terma shqip, tregon për kujdesin që tregohet në çdo fushë të dijes e të shkencës për të ruajtur karakterin kombëtar të terminologjisë.

Në terminologjinë e urbanistikës, përvèç termave të shqipëruar në fushat e tjera, por që, në bashkëvajtje me një term të urbanistikës në togfjalësh, bëhen terma të kësaj fushe, janë shqipëruar edhe terma të tjerë si psh: degradim (urban) - tatëpijtë (urbane), heterogenitet (urbanistik) - përzjerësi (urbanistike), instrument (urban) - mjet (urban), masterplan - plan i përgjithshëm, (ndërtim) kaotik - (ndërtim) i rrëmuishëm, unifikim (i lartësisë së ndërtesave) - njësim (i lartësisë së ndërtesave), (plan) i detajuar - (plan) i hollësishëm, arrit (i planëzimit urban) - ngërç (i planëzimit urban), rinovim (urban) - përtëritje (urbane), {zonë urbane} buferike - (zonë) ndarëse, uniformitet (i tipologjisë urbanistike) - njëtrajtshmëri (e tipologjisë urbanistike) etj..

Ky kujdes është treguar edhe për shqipërimin e ndajshtesave psh: disurbanizim – çurbanizim, infrastrukturë – nënstrukturë, epiqendër – kryeqendër, struktural – strukturor, arkitektural – arkitekturor, kompozicion – kompozim, kompozicional - kompozimor etj..

b) • Në rrashin strukturor-fjalëformues, natyrisht, fjalët e reja janë formuar sipas mënyrave dhe me mjetet fjalëformuese të gjuhës:

1) Me ndajshtesim: • emra: çurbanizim (i territorit), njëtrajtshmëri (e tipologjisë...), përputhshmëri (e planeve...), përshtatshmëri (e territorit), shformim (i territorit), papërzjerësi (urbanistike) etj.; • mbiemra: (objekt...) i përhershëm, (planëzim ...) ndërpërmasor, (planëzim) bashkëvajtës etj.

2) Gjithashtu, gjatë punës për bashkërendimin e terminologjisë, për forcimin e karakterit sistemor të saj, ndërtohen terma edhe sipas lidhjeve fjalëformuese që kanë të bëjnë me dy grupime: grupimi që ka në bazë të njëjtën morfemë rrëniore dhe grupimi në bazë të ndajshtesave.

- Vargje që kanë në bazë të njëjtën morfemë rrëniore: urban-e - urbanistik-e - urbanistikë - urbanizim - çurbanizim - riurbanizim; gendër - qendor - kryeqendër - shumëqendërshe etj..
- Vargje që kanë në bazë të njëjtën parashtesë: (planëzim...) ndërpërmasor, (rrjet) ndërpytetës, ndërhyrje (urbanistike); rëmodelim (urban), rëndërtim (urban), rëorganizim (hapësirës...), rëpërtëritje (urbane), rëstrukturim (i hapësirës...); bashkërendim (i planeve...),

(*sipërfaqe*) bashkëshoqëruese, (*rritje*) bashkëqendrore (*e qytetit*); (*zonë*) paraubane, paraprojekt (*urbanistik*), paraplan (*urbanistik*); nënnjësi (*urbanistike*), nënstrukturë (*urbane*), (*objekt urban*) nëntokësor (*i territorit*) etj..

- Vargje që kanë në bazë të njëjtën prapashtesë; (*zonë*) rrethinore, (*element*) kompozimor, (*nënnjësi...*) strukturore, (*përvijim*) hapësinor, (*vijueshmëri*) ndërtimore, (*njësi...*) studimore, (*element*) pikësor, vijor; (*element...*) lidhës, (*plan...*) mbështetës; (*plan...*) rregullues, (*vijë*) kufizuese; (*ndërtim*) i rrëmujshëm, (*kompozim...*) i lirshëm, (*planëzim...*) i hollësishëm; frytshm-ëri (*e planëzimit...*), vijueshm-ëri (*ndërtimore*); tjetërsim (*urban*), planëzim (*urban*), kufizim (*i hapësirës...*), mbulim (*i territorit...*), copëtim (*i territorit*), ekonomizim (*i truallit*), zonim (*territorial*) etj..
- Me kompozim: (*element*) qytetformësues, planvendosje (*e skeletit...*), (*skemë...*) njëqendërshe, (*ndërtime*) tripërmasore, (*planëzim*) gjithëpërfshirës; element-gjurmë (*planit...*), (*ansambël*) urbanistiko-arkitekturor, sipërfaqe-dysheme (*urbanistike*) etj..
- Terma-togfjalësha si formime sintaksore që, si në terminologjinë e çdo fushe, janë jo të paktë në numër, në këtë terminologji fjalësi është kryesisht me terma-togfjalësha si: arterje rrugore, çështje urbanistike, ekonomizim i truallit, fisionomi urbana, koncept urbanistik; bashkërendim i planeve urbanistike, model i strukturës urbana, ndërtuesë me drejtim të detyruar, njësi urbanistike studimore; analizë e të dhënave për planëzimin urban, plan urbanistik i hapësirës urbana, prishje e vijës kufizuese të ndërtimit etj..

Por, kur termi nuk është ndërtuar drejt gjuhësisht, është emërtim i pasaktë i konceptit, si në rastet e mëposhtme: **a)** nga mospërdorimi i drejtë i ndajshtesave si psh: (*mënyrë*) planifikuese. Ndërtuar kështu do të thotë: mënyra që planifikon. Natyrisht, nuk planifikon mënyra, por planifikohet sipas një mënyre, prandaj termi duhet të jetë: mënyrë planëzimi... Po kështu, edhe termat: skemë kompozuese, territor i ndërtueshëm, duhen ndërtuar drejt: skemë kompozimi, territor për ndërtim etj..

b) nga mospërdorimi i duhur i fjalëve, si në këto raste: • përdoret termi planifikim (*urban*). Termi planifikim është formuar nga termi plan por, sipas FGJSSH⁴ nga kuptimi i dytë ose i tretë i këtij termi që i përkasin fushës së ekonomisë ose organizimit të një veprimtarie,

⁴ Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Institut i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1980.

ecurisë së zhvillimit të saj, ndërsa si term i urbanistikës duhet të ketë në bazë kuptimin e parë të termit plan që i përket urbanistikës: "*lloj vizatimi që paraqit me anë vijash e shenjash të posaçme, në shkallë të zgjedhur një sipërfaqe toke; hartë e shkallëzuar; vizatim që paraqet - prerjen sipas një rrafshi të një ndërtese*". Në këtë kuptim termi planëzim që ka shkurtesën usht, në FGJSSH e jep saktë edhe kuptimin që ka në terminologjinë e urbanistikës: planëzoj - *bëj planin e hollësishëm...të veprimeve...të reparteve - në mësymje ose térheqje*). Veprimet (mësymja, térheqja) që bëhen në terren, janë parashikuar dhe skicuar më parë në plan, ashtu siç mendohet nga urbanistët se si do të vendosen në territorin e caktuar objektet ndërtimore, prandaj ky term, i huajtur nga terminologjia e ushtrisë, është termi i saktë që duhet përdorur edhe në terminologjinë e urbanistikës. Gjithashtu, nuk përdoren drejt termat: dendësim i territorit, ndërsa termi i duhur është : mbulim i territorit (*me objekte urbane*), intensitet i ndërtimit për: koeficient i shfrytëzimit të hapësirës urbane, lokalisim i ndërtimit për: kufizim i hapësirës urbane ndërtimore, (*element*) qytetformues për: (*element*) qytetformësues, (*ndërtesa*) të përqendruara për: (*ndërtesa*) të grupuara, (*politikë*) territoriale për (*politikë*) për shfrytëzimin e territorit etj.

c) Me prejardhje kuptimore, domethënë, kur ruhet fjala e leksikut të gjuhës ose termi i një fushe tjeter, por ndryshon përbajtja e tyre. Fjala-term emëron një koncept tjeter, në këtë rast një koncept në fushë të urbanistikës, psh.: - fjala çarçaf si kuptim të parë në FGJSSH ka: "*pëlhurë që shtronhet mbi dyshek*", kurse në njësitë frazeologjike, në përgjithësi, ka kuptim negativ, si në shembullin "*e ka mendjen çarçaf*", kuptim që mund të përafrohet ose të jetë në bazë të kuptimit që jep togfjalëshi terminologjik: (*formë urbane*) çarçaf, pra formë urbane e çrrregullt. Kurse në togfjalëshin: (*formë urbane*) çarçaf i nyjetuar, ka në bazë kuptimin e vetëm të mbiemrit: i nyjetuar, si term i gjuhësisë (*gjuhë e nyjetuar*) përbajtja e të cilët tregon të folurit duke vënë në lëvizje organet e të folurit në një mënyrë të caktuar, domethënë, në një mënyrë të rregullt (termi i urbanistikës: (*formë urbane*) çarçaf i nyjetuar hyn si antonim i termit (*formë urbane*) çarçaf).

- Gjurmë (*e strukturës ndërtimore*) - Në FGJSSH: "*shenjë që mbetet mbi sipërfaqen e diçkaje*", kurse termi-togjalësh i urbanistikës emëron *shenjën që tregon trajtën e bazës së strukturës ndërtimore* në plan.

- **Krisë (urbanistike)** - Në FGJSSH: "plasë e hollë që merr gota", kurse si term në urbanistikë emërtion një hapësirë gjatësore të ngushtë që krijohet gjatë kompozimit të një bloku ndërtimor, për të lehtësuar qarkullimin publik.
- **Mobilim (urban)** - Në FGJSSH jepet vetëm me kuptimin: pajis me mobilje, dhomën, zyrën, kurse si term i urbanistikës jep kuptimin: pajisje me objektet e duhura të një mijedisi çlodhës në natyrë.
- **Nyjë (urbane)** - Në FGJSSH: "vendi a pika ku bashkohen shumë rrugë". Si togfjalësh- term i urbanistikës: objekt me vlera të ndryshme (historike, kulturore, natyrore, monumentale), që bëhet pikë orientuese për konceptimin e organizmit urbanistik të elementeve urbane.
